

Vendim nr. 194 datë 23.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 23.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: GENTIANA SHATA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5262, datë 30.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 00-2024-197 (42), datë 30.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Gentiana Shata është konfirmuar nëpunëse civile në pozicionin “specialiste”, në sektorin e shitjes së pronave, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (*DASHPP*) pranë Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 209/2 prot., datë 03.02.2009 të Departamentit të Administratës Publike (*DAP*).

2. Me urdhrin nr. 179, datë 18.10.2013 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave” është miratuar organika e re e kësaj ministrie. Në bazë të këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 16955 prot., datë 08.11.2013, ka njoftuar kërkuesen për kalimin në listëpritje, në pamundësi të ofrimit të të njëjtit nivel ose të një niveli më poshtë. Në vijim, me shkresën nr.1650/3 prot., datë 26.11.2013, *DAP*-i është shprehur për kalimin në listëpritje të kërkueses.

3. Me shkresën nr. 16955/2 prot., datë 09.12.2013 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, është bërë njoftimi i miratimit të kalimit në listëpritje të kërkueses, ndërsa me shkresën nr. 16955/3 prot., datë 09.12.2013 të tij është miratuar kalimi në listëpritje. Në vijim, me urdhrin e tij nr. 17263/4 prot., datë 09.12.2013, është vendosur pagimi i punonjësve të Ministrisë së Financave në listëpritje.

4. Në datën 10.07.2014 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative të lartpërmendura të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe të shkresës nr. 1650/3, datë 26.11.2013 të *DAP*-it, si akte të nxjerra në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe në shkelje flagrante të ligjit; (ii) detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Financave dhe personit të tretë, *DAP*-it, për rikthimin e kërkueses në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel, duke gëzuar të drejtat e vendit të mëparshëm të punës; (iii) detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Financave, për të kryer pagesën nga data 16.12.2013 deri në momentin e kthimit në punë.

5. Me vendimin nr. 5262, datë 30.09.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Sipas saj, ndryshe nga sa pretendon paditësja (kërkuesja), ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*) nuk ka qenë ligji i zbatueshëm në çastin e nxjerrjes së akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor, por i tillë ka qenë ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*). Sipas asaj

gjykate, akti administrativ që kundërshtohet është në formën shkresore të kërkuar nga ligji, ndërsa është respektuar edhe procedura e parashikuar nga ligji për nxjerrjen e tij, e cila ka filluar me njoftimin e paditëses për kalimin në listëpritje, njoftimin e miratimit të kalimit në listëpritje dhe njoftimin për vendimin e miratimit të kalimit në listën e pritjes. Kundër këtij vendimi kërkesja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

6. Me vendimin nr. 4385, datë 07.12.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkesja është emëruar sipas procedurave të konkurrimit, sipas ligjit nr. 8549/1999, por ajo është larguar në një periudhë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 152/2013, ndaj procedurat që duheshin ndjekur në rastin e saj janë ato sipas këtij ligji. Lidhur me këtë, gjykata e apelit ka vërejtur se neni 72 i ligjit nr. 152/2013 ka përcaktuar hyrjen e tij në fuqi në datën 01.10.2013, ndërkohë që me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 të Këshillit të Ministrave kjo dispozitë u ndryshua, duke përcaktuar se ligji hyn në fuqi në datën 01.10.2013, ndërsa efektet e tij fillojnë 6 muaj pas hyrjes në fuqi dhe se deri në datën e fillimit të efekteve zbatohet ligji nr. 8549/1999. Megjithatë akti normativ në fjalë u shfuqizua me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*). Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, në analizë edhe të përmbajtjes së nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, shfuqizimi i aktit normativ sjell si pasojë që efektet e ligjit nr. 152/2013 të nisnin që nga data e hyrjes në fuqi të tij, pra *ex tunc*, ndaj në rrethanat kur ky ligj ka hyrë në fuqi më 01.10.2013, edhe situata faktike juridike në rastin në shqyrtim rregullohet nga dispozitat e tij. Për sa i përket themelit të çështjes, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se aktet administrative objekt padie janë absolutisht të pavlefshme, duke vlerësuar se neni 50 i ligjit nr. 152/2013 nuk parashikon mundësinë e nxjerrjes në listëpritje të nëpunësit civil dhe as kompetencën e sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përkatëse për nxjerrjen e një urdhri të tillë, ndaj, sipas saj, pala e paditur ka pasur detyrimin për të sistemuar paditësen në një vend tjetër pune. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave, dhe personi i tretë, DAP-i. Kërkesja ka paraqitur kundërrekurs.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-197 (42), datë 30.01.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, pasi i ka dhënë fuqi prapavepruese ligjit nr. 152/2013. Ajo ka arsyetuar

se aktet objekt gjykimi datojnë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 dhe e gjithë procedura për kalimin e paditëses në listëprirje ka nisur dhe ka përfunduar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri, ndërsa kërkesëpadia i është drejtuar gjykatës në datën 10.07.2014, gjë që e bën të detyrueshme zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8549/1999. Në vijim, sipas asaj gjykate, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, kohë kur çështja objekt shqyrtimi nuk ishte ngritur ende, ndaj ai nuk mund të sjellë efekte në atë rast, referuar ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit vendimet e Gjykatës Kushtetuese sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Po kështu, sipas Gjykatës së Lartë, në rastin në shqyrtim nuk jemi as përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenin 76 të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me fuqinë prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimin e Gjykatës së Lartë, konstatimi i gjykatës së apelit nuk kënaq kërkesat e ligjshmërisë, pasi ligji nr. 152/2013 nuk është baza normative që rregullon marrëdhënien juridike mes palëve ndërgjyqëse.

8. Në datën 22.07.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 31.07.2024.

II

Pretendimet e kërkeses

9. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt*, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë pas 8 vjetësh nga gjykimi në gjykatën e apelit dhe ajo nuk ka arsyetuar në vendim shkaqet që e kanë çuar në trajtimin me vonesë të kësaj çështjeje administrative, ndërkohë që ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ka parashikuar një afat 90-ditor.

9.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur dy standarde, për sa kohë që në çështje të tjera administrative që kanë të bëjnë me paditë e paraqitura nga kolegë të kërkeses, ka vendosur mospranimin e rekursit të Ministrisë së Financave dhe DAP-it, edhe pse çështjet kanë qenë të ngjashme.

9.2. *Parimi i mosdiskriminimit*, pasi gjykata administrative e shkallës së parë, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, ka detyruar kërkesen për pagesën e taksës

së padisë, ndërsa në të gjitha çështjet e tjera analoge për punonjësit e drejtorisë ku ka punuar kërkuesja, ata janë përjashtuar nga kjo taksë. Po kështu, Gjykata e Lartë jo vetëm që nuk ka dhënë argumente për kundërrekursin e kërkueses, por ka ndërhyrë në thelbin e çështjes, duke gjykuar me dy standarde dhe duke mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të njëjta.

- 9.3. *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak se Gjykata e Lartë ka ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit dhe i ka mohuar kërkueses të drejtat e garantuara në Kushtetutë. Gjykata e apelit me të drejtë ka arsyetuar në lidhje me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret dhe, në referim të ligjit nr. 152/2013, ka konstatuar absolutisht të pavlefshme aktet objekt gjykimi, duke theksuar se pala e paditur ka pasur detyrimin për të sistemuar palën paditëse në një vend tjetër pune.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Në

jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetohet se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kërkuesja ka pretenduar, në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt, edhe cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin e gjykimit të çështjes dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet që e kanë çuar në shqyrtimin me vonesë të çështjes së kërkueses. Kolegji vëren se ky pretendim është ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual, pa u shfrytëzuar më parë nga kërkuesja mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, që i garantojnë asaj mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e kësaj të drejte. Po kështu, kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e parimit të mosdiskriminimit, me argumentin se gjykata administrative e shkallës së parë e ka detyruar atë për pagesën e taksës së padisë, ndërkohë që të gjitha çështjet e tjera analoge për punonjësit e drejtorisë ku ka punuar kërkuesja janë përjashtuar nga kjo taksë. Kolegji vëren se ky pretendim i kërkueses nuk rezulton të jetë ngritur prej saj në ankimin drejtuar gjykatës së apelit dhe as nuk është konsideruar si shkak për të paraqitur rekurs ndaj vendimit të asaj gjykate (e cila ka pranuar padinë), sikundër nuk është parashtruar as në kundërrkurs. Për rrjedhojë, edhe në lidhje me këtë pretendim kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, parashikon afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 30.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 22.07.2024. Sipas shkresës së Gjykatës së Lartë bashkëlidhur kërkesës, rezulton se vendimi i asaj gjykate, objekt i ankimit kushtetues individual, është zbardhur në datën 20.03.2024, datë pas së cilës kërkuesja konsiderohet se ka marrë dijëni efektivisht për të. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të

arsyetimit të vendimit, si dhe parimin e mosdiskriminimit, për sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë në çështje të ngjashme, ashtu edhe parimin e sigurisë juridike. Kolegji vlerëson se këto pretendime, *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohen në vijim, së bashku, në drejtim të bazueshmërisë së tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të mosdiskriminimit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

16. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë ka gjykuar me dy standarde, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai mbajtur në raste analoge, me objekt dhe bazë ligjore të njëjtë, që kishin të bënin me persona të punësuar pranë së njëjtës palë të paditur e që ndodheshin në situatë të njëjtë faktike, duke vendosur mospranimin e rekurseve të Ministrisë së Financave ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta që u kishin njohur atyre paditësve të drejtat që buronin nga ligji nr. 152/2013, i identifikuar në ato raste si ligji i zbatueshëm. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka ndërhyrë në thelbin e çështjes dhe ka ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit duke i mohuar kërkueses të drejtat e garantuara në Kushtetutë, ndërkohë që gjykata e apelit me të drejtë ka arsyetuar se ligji i zbatueshëm në rastin konkret është ligji nr. 152/2013 dhe në referim të tij ka konstatuar absolutisht të pavlefshëm aktet objekt gjykimi, duke theksuar detyrimin e palës së paditur për të sistemuar kërkuesen në një vend tjetër pune.

17. Kolegji vëren se këto pretendime kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka arsyetuar në rastin e kërkueses në lidhje me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e lidhur kjo edhe me zbatimin e nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000 në drejtim të efekteve të vendimit nr. 5, datë 05.02.2014 të kësaj Gjykate.

18. Gjykata ka theksuar se zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë përpara ligjit. Ky i fundit së bashku me parimin e sigurisë juridike ndërlidhen midis tyre me qëllim garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund të referohen në vendime gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre (*shih vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të

interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo Gjykatë nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji vëren se ligji nr. 152/2013 është miratuar nga Kuvendi në datën 30.05.2013 dhe sipas nenit 72 të tij ai hynte në fuqi në datën 01.10.2013. Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil””, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 30.09.2013. Akti normativ ka ndryshuar nenet 70 dhe 72 të ligjit nr. 152/2013, duke parashikuar se ky ligj hynte në fuqi në datën 01.10.2013 dhe i fillonte efektet 6 muaj pas hyrjes në fuqi e se deri në datën e fillimit të efekteve të tij do të zbatohet ligji nr. 8549/1999. Për rrjedhojë, në kohën kur janë nxjerrë aktet administrative të kundërshtuara nga kërkuësja (në datat 08.11.2013, 26.11.2013 dhe 09.12.2013) kanë qenë të zbatueshme parashikimet e ligjit nr. 8549/1999, për sa kohë që ligji i ri nr. 152/2013 nuk kishte filluar ende efektet.

20. Me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014, Gjykata ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 30.09.2013, vendim që ka hyrë në fuqi, në përputhje me parashikimet e nenit 132 të Kushtetutës, në datën 26.02.2014, pas botimit në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, në rastet kur Gjykata shfuqizon një ligj ose akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimi i saj, si rregull, sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi, dhe se ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë (*pika 7, shkronja “b”*).

21. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, si dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, konstaton se kërkuësja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në datën 10.07.2014, pra pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës. Për rrjedhojë, sikurse Gjykata e Lartë është shprehur, për sa kohë që në momentin që ka hyrë në fuqi vendimi i kësaj Gjykate çështja e kërkuësës nuk ka

qenë në shqyrtim përpara gjykatave të zakonshme, ky vendim nuk mund të sillte efekte në atë çështje.

22. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, duke interpretuar dispozitat e zbatueshme në rastin konkret në këndvështrim të rrethanave konkrete të çështjes me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm nga gjykata për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuesja, interpretimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret jo vetëm që nuk është arbitrar apo haptazi i paarsyeshëm, por ajo gjykatë, në mënyrë të plotë dhe shteruese, ka parashtruar në vendimin e saj të gjitha argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv.

23. Kërkuesja, në mbështetje të pretendimeve të saj, ka paraqitur bashkëlidhur kërkesës edhe disa vendime të tjera të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilat është vendosur mospranimi i rekurseve të paraqitura nga pala e paditur, Ministria e Financave. Kolegji, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, konstaton se rrethanat e faktit në ato raste, konkretisht për sa i përket fazës në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes në gjykatat e zakonshme, e lidhur kjo me efektet prapavepruese të vendimit të Gjykatës, në zbatim të nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, janë të ndryshme nga ato të kërkueses (*shih vendimet nr. 00-2022-127, datë 03.02.2022; nr. 00-2022-1269, datë 29.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, Kolegji nuk konstaton që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të ketë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të zbatimit dhe interpretimit të ligjit të zbatueshëm.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses janë haptazi të pabazuara ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.